



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 51027

Më: 26 prill 2024

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 26 prill 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:12 minuta.

**Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin:** Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj dhe Florent Ukaj, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Mungoi:** Egzona Hoxhaj dhe Levent Buş dhe Bajram Kastrati.

**Pjesëmarrës tjerë ishin:** Kujtim Gashi, Nënkyetar i Komunës, Gjafer Ponik nga DEF, Mybexhele Zhuri nga Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Rahim Destani Kryesues i Komisionit për hartimin e Rregullores, si dhe OJQ-të e Mediat.

**Antigona Bytyqi:** Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar Nënkyetar, të nderuar zyrtar të drejtorive, media, përshëndetje për të gjithë. Siç jeni të njoftuar për sot kemi thirr mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi 5 anëtarë të këtij Komiteti, presim që të na bashkëngjiten edhe të tjerët. Për rend dite kemi këto pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve: 04 mars 2024 dhe 27 mars 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për shërbime publike komunale në komunën e Prizrenit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-48190 të datës 31 mars 2022;
5. Raporti financiar janar-mars 2024;
6. Informatë rreth raportit të punës të Zyrës-Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2023;

**Antigona Bytyqi:** Po fillojmë menjëherë me pikën e parë.

### Pika e parë:

**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve: 04 mars 2024 dhe 27 mars 2024;**

**Antigona Bytyqi:** A keni dikush diçka me shtu rreth kësaj pike? Në qoftëse jo, atëherë po i hedhë menjëherë në votim. Prezent jemi 5 anëtarë, kush është për që të miratohen procesverbalet? Unanimisht, faleminderit. Kalojmë te pika e dytë.

### **Pika e dytë:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;**

**Antigona Bytyqi:** Po, Ademi e ka fjalën.

**Adem Shabanaj:** Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Meqënëse nuk paska shumë pika të rendit të ditës për këtë seancë të rregullt, në cilësinë e anëtarit të komisionit të aksionerëve në stacionin e autobusave, kërkoj nga KPF që ta futim në rend dite edhe raportin e funksionimit të kësaj ndërmarrje. Nëse veç e shihni të arsyeshme me prezantu raportin juve të kësaj.

**Antigona Bytyqi:** Mirë po e shohim njëherë a po e shtyjme në rend ditë pastaj e prezanton.

**Adem Shabanaj:** Në rregull, nëse e shihni të arsyeshme me kanë raporti mirë, nëse jo atëherë e lëmë për seancën tjetër.

**Antigona Bytyqi:** Ok, ju faleminderit. Dikush tjetër? Në qoftë se jo atëherë e patëm një propozim që raporti i komisionit të aksionerëve të stacionit të autobusave për 2023 që të jetë në rend të ditës dhe t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme që e kemi. Kush është për që ky propozim të hyjë në rend? Pesë jemi, unanimisht ju faleminderit. Atëherë po e hedh rendin e ditës në tërësi në votim, bashkë me propozimin që u bë nga zotëri Adem. Kush është për që të miratohet ky rend ditë? Unanimisht ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e tretë,

### **Pika e tretë:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për shërbime publike komunale në Komunën e Prizrenit.**

**Antigona Bytyqi:** Për këtë pike prezent e kemi përfaqësuesin e drejtorisë të cilit ja kalojmë fjalën.

**Rrahim Destani:** Atëherë prej Drejtorisë së Inspektoriateve janë unë. Unë kam këtu një raport që nuk e di a më shkurt apo pak më të gjatë, që ndoshta kemi kohë më shumë ose më pak.

**Kujtim Gashi:** Sa më shkurt.

**Antigona Bytyqi:** Sa më shkurt, meqë e kemi edhe në kuvend.

**Rrahim Destani:** Po e kemi edhe në kuvend edhe aty më gjerësisht e sqarojmë.

**Dafina Alishani:** Më fal, ju jeni prej inspektoriateve?

**Rrahim Destani:** Po nga drejtorja e inspektoriateve.

**Dafina Alishani;** Por Rregullorja është e juaja e jo e shërbimeve publike.

**Rrahim Destani:** Po e jona, na e kemi hartu draftin e rregullores dhe ne e zbatojmë rregulloren, një pjesë Drejtorja e Inspektoriateve, një pjesë tjetër drejtoritë tjera të Kuvendit komunal.

**Kujtim Gashi:** Sponzor janë këta.

**Rrahim Destani:** Na Drejtoria e inspektorateve e kemi propozuar. Me propozim të, a mundemi me fillu?

**Karanfil Haxhillari:** Veç pak, ama veç pak, veç ti sqarojmë do sende. Titulli thotë projekt-propozim rregullore për shërbime publike komunale.

**Rrahim Destani:** Po qashtu është.

**Kujtim Gashi:** Këqyre, kjo është rregullore e përgjithshme, po prej drejtorisë së tyre është iniciuar edhe është koordinator i grupit punues.

**Rrahim Destani:** Kryesuesi i komisionit.

**Kujtim Gashi:** Po udhëheqës i komisionit që e ka hartuar rregulloren.

**Karanfil Haxhillari:** Aha në cilësinë e anëtarit të komisionit të rregullores.

**Rrahim Destani:** Kryesuesit i komisionit.

**Karanfil Haxhillari:** Kështu po, a e di se unë mendova se, në rregull.

**Rrahim Destani:** Po unë desha me u prezantuar. A mund me filluar?

**Antigona Bytyqi:** Po po.

**Rrahim Destani:** Faleminderit zonja kryesuese, i nderuar nënkryetarë, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politike Financa. Me aprovim të Drejtorisë së Inspektorateve, kryetari i komunës së Prizrenit, zoti Shaqir Totaj, me vendim numër 01-010/2024 të datës 12/01/2024 dhe ka formuar grupin punues për hartimin e rregullores për shërbimet publike komunale. Grupi punues ka filluar punën me datën 22.01.2024, dhe ka mbajtur shtatë takime deri në hartimin e draftit të kësaj rregullore. Rregullorja për shërbime publike komunale në pjesën më të madhe është përmbajtja e vendimit komunale rregullimin e qytetit dhe shërbimeve komunale numër 01/011-2 i datës 18. 11 2004. Meqënëse e kemi pak më shkurt, këtu e kam lokalizuar unë. Nëse ka nevojë si raport ja jap me me lexu. Me këtë rregullore synohet të sigurohet efektiviteti në punën e inspektoratit dhe drejtorive tjera komunale. Ndryshohet hyrja dhe baza ligjore, rregullimi dhe harmonizimi i gjobave sipas ligjit të ri për kundërvajtje. Kjo rregullore përmban ujësjellësin dhe kanalizimin, ndriqimin publik, sipërfaqet publike, rrugët dhe trotualet, objektet e përkohshme, kiosqet, tavolinat dhe karriget, autobusëve , tezgat e të tjera. ndërtesat e pamja e tyre jashtme, vitrinat, rrethojat, gropat dhe pusetat në rrugë, terrenet sportive, ndriqimi publik, tregjet, pastimi i borës dhe probleme të tjera komunale që janë në komunën tone. . Këtu nëse duhet specifikisht për secilën veç e veç mund me e sqaruar për secilën pikë, nëse ka nevojë ne mund me e sqaru. Nëse jo, atëherë kjo është në përgjithësi si përmbajtje e rregullores.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit. Prej anëtarëve dikush fjalën? Po, Karanfil fjala për juve.

**Karanfil Haxhillari:** U përmendën këtu reklamën, u përmendën edhe këto çështje të tjera të cilët veç deshta një pyetje me bë, a ka kaluar ligjshmëria e asaj rregullore për reklamën në komunën e Prizrenit.

**Antigona Bytyqi:** Nuk ka, jo rregullore, Vendimit.

**Kujtim Gashi:** Po e vendimit ka ardhë.

**Karanfil Haxhillari:** Domethënë ka kaluar qajo.

**Antigona Bytyqi:** Po ka ardhë si i ligjshëm.

**Karanfil Haxhillari:** Në rregull se a e din ndonjëherë po bëhen rregullore në konflikt njëra me tjetrën edhe nuk po e dimë më pastaj se çfarë, qysh edhe po përzihet. Kjo ishte.

**Antigona Bytyqi:** Dikush tjetër? Po urdhro Dafina.

**Dafina Alishani:** Këtu te neni 3 thotë që objektet komunale publike në mbështje të kësaj rregullore konsiderohen, i keni numëruar disa, edhe ndër ta është edhe terrenet sportive. Me sa e di unë, ne kemi një bord edhe një rregullore për menaxhimin e objekteve kulturore dhe sportive. A mos po bëjmë ndesh dy rregullore, sepse tash kjo është përgjegjësi e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kurse DKRS-ja e ka përgjegjësi me i menaxhuar edhe me i mirëmbajtur edhe terrenet sportive edhe objektet kulturore. Kjo ke pyetja e parë. Edhe e dyta, disa fushëveprime këtu të urbanizimit janë futur në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kiosqet, hapësirat e përbashkëta ose hapësirat gjelbëruese, okej, mirëmbajtja i takon DSHP-së, por në aspekt lejes ka qenë më herët në urbanizëm. Ose për shembull, konstruksionet që janë me afat shkurt, për afat shkurt, shfrytëzimi i hapësirave për afat shkurt. Me sa e di unë më herët ka qenë e menaxhuar prej urbanizimit. Tash me sa po e shoh të gjitha përgjegjësitë e disa drejtorive i pasket fuzionuar në DSHP. Arsyeja e kësaj, pse është kështu?

**Rrahim Destani:** A mund të më përgjigjesh?

**Antigona Bytyqi:** Po po, patjetër.

**Rrahim Destani:** Këtu janë vetëm rregullat se si duhet me u pajis me leje. Drejtorja e Inspektorave e bënë vetëm mbikëqyrjen, kontrollin inspektues, dëmtimet e rrugëve, trotuareve, vendosja e barakave, kjosqeve pa leje, dëmtimi i tereneve sportive nëse mund krejt pyetjet kështu me i përgjegjësuar si i bëni të dyja. Edhe terrenet sportive, kur trajtohen si objekte komunale ose hapësira publike, inspektorati komunale, domethënë është përgjegjës, nëse dikush ka me e dëmtuar infrastrukturën e stadimeve për shembull infrastrukturën sportive, stadiumet ose qendra të tjera sportive që i kemi qendrën sportive, mund me e dëmtuar gjelbërimin, mund me e dëmtuar kanalizimin, mund mënyra të ndryshme e dëmtojnë. Kyqjet pa leje në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit i jep Drejtorja e Urbanizimit, mirëpo i inspekton inspektorati komunal në terren.

**Dafina Alishani:** E Hidroregjioni ku mbetet këtë rast?

**Rrahim Destani:** Hidroregjioni është kompani publike, ne e kontrollojmë vetëm kur e dëmton rrugën, edhe kur ka nevojë për me bërë analiza për ujë, nëse dyshohet diçka institutit duhet me e

thirrë meqenëse inspektor sanitar tash nuk kemi. Mirëpo megjithatë duhet me u interesuar dhe ne për ato punët tjera. Domethënë nuk ka të bëjë me atë që ne kemi marrë kompetencë, këto kompetenca kanë qenë me vendim komunal për rregullimin e qytetit dhe shërbimet komunale. Mirëpo këto vetëm i kemi bërë këto ndryshime për shkak të hyrjes dhe bazës ligjore, e cila ka qenë pak e vjetër dhe ka filluar me rënë në konflikt me ligjet e reja. Për qet arsye jemi detyruar me bërë këtë rregulloren e re.

**Dafina Alishani:** A i bje që pa rregullore nuk ka pasur mundësi me implementuar ligjin apo keni pritë rregulloren.

**Rrahim Destani:** Jo jo, kur i përmendët ju më përpara konstruksionet të tjera atje trajtohen me ligj për ndërtim, Pra me ligjin e ndërtimit, këto nuk trajtohen me këtë rregullore.

**Dafina Alishani:** Po urbanizmi e ka fushëveprim atë.

**Rrahim Destani:** Fushëveprim e ka urbanizmi me dhënë leje dhe me ja kontrolluar është inspektorati.

**Dafina Alishani:** Atëherë ndërrojani emrin rregullore, emërtojani rregullore për inspektorat.

**Rrahim Destani:** Jo jo, kjo s'është për inspektoriat, kjo është për shërbime publike komunale, DSHP-ja, jep pëlqim për me prish asfaltin po supozojmë për me prerë rrugën, Drejtoria e Urbanizimit jep leje, inspektorati e mbikëqyr.

**Dafina Alishani:** Unë veç një pyetje e kam, kjo rregullore nëse nuk respektohet. Unë po e shoh një shkelje, te cila drejtori duhet me u, nëse është sponsorizues Drejtoria e Shërbimeve Publike?

**Rrahim Destani:** Jo s'është DHSP-ja, sponsorues jemi na.

**Kujtim Gashi:** A bën me ndërhy pak?

**Dafina Alishani:** A jeni tuj e kuptuar?

**Kujtim Gashi:** Po veç mos të keqkuptohet, domethënë shërbimet publike, nuk është në këtë rast te rregullorja emër, është si shërbim, është për shërbimet publike që jep komuna, jo për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

**Dafina Alishani:** Po kush është përgjegjës, kush është përgjegjës? Tash unë po e supozoj që po e shoh një shkelje edhe nuk po respektohet rregullorja. Cila drejtori e ka përgjegjësi këtë respektimin e kësaj rregullore?

**Kujtim Gashi:** Secila në fushën e vet. Secila në shërbimet e veta që ofrohen.

**Rrahim Destani:** Secila në përgjegjësitë e veta.

**Kujtim Gashi:** Tash njëfarë policie e komunës është inspektorati.

**Dafina Alishani:** Kujtim ngom, a e din ku e kam brengën, brengën e kam kështu. Nëse janë dy rregullore të cilat merren me objekte të njëjta, cilido qytetar që ka me shkuar me u ankuar ka me qenë inspektoriati ka me dërguar në DKRS, DKRS-ja ka me dërguar në, si një farë lloj lufte që është mes inspektoriatit edhe QRTK-së. Ata thonë inspektoriati nuk po i monitoron, ju thoni që QRTK-ja nuk po i monitoron. Unë e kam hallin veç mos të mbetet një hapësirë që asnjë drejtori mos me marrë kompetenca. Nëse ka rregullore për menaxhim të terreneve sportive është dashur me qenë përgjegjës të DKRS-ja.

**Rrahim Destani:** Zonja, vetëm ta sqarojmë edhe një diçka. Vetëm dëmet që shkaktohen brenda objekteve sportive, ato të tjerat me fusha menaxhuese nuk i takon Drejtorisë së inspektoriateve, vetëm ne jemi organ ekzekutiv. Do të thotë nëse po e flasim edhe njëherë, nëse një person e ka prerë rrugën nuk është pajis me leje, nuk u pajis me pëlqim prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, rruga është hapësirë publike. Nuk ka marrë leje prej Drejtorisë së Urbanizimit për qëllime të ndryshme, me marrë një rrjet, një lidhje të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrymës, ose të telefonit, çfarëdo lloj pune që ka bërë në terren. Edhe këtu duhet fillimisht me marrë pëlqim prej DSHP-së, dhe leje prej Drejtorisë për Urbanizëm, që me ditë ku u prish rruga në mënyrë që me intervene me u rregullu. Fillimisht ata paguajnë një taksë në bazë të rregullues për taksa dhe ngarkesa për metër asfalti dhe meter kubza sa është e paraparë në, mos paragjykoj tash çmimin edhe i lëshohet leja. Meqënëse është shërbim komunal, duhet patjetër ai me pas rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit se unë s'jam me kyq rrjetin elektrik ose është kablo po supozojmë. Qkjo është problemi se shërbimet komunale janë në përgjithësi këto që po i trajtojmë ne. Nuk ka të bëjë, nuk ka përzierje të kompetencave, kjo është kompetencë shumë e ndame edhe shumë e qartë është. Drejtorja e Shërbimeve Publike i ka këtu të shkruara, te ujësjellësi dhe kanalizimi i ka punët e veta që i ka marrë si përgjegjësi gjatë grupit punues që kemi kontaktuar edhe me drejtorin edhe me ekspertët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Meqënëse kemi pasur një grup punues edhe Laurën edhe me drejtorin Çel Lamaj e kemi konsultuar për disa edhe kemi kërkuar bashkëpunim me hidroregjionin Jugor, edhe ata i kanë dhënë, e kemi pa edhe harmonizuar me rregulloren me të cilën punojnë ata edhe kemi vepruar. Domethënë përzimje të kompetencave këtu nuk ka. Fusha menaxhuese i takon drejtorive respektive që janë këtu. Fusha e kontrollit edhe inspektimeve i takon inspektorat komunal, të ndërtimit, pjesë pjesë edhe të mjedisit. Domethënë këto janë fushat që kanë me u inspektuar.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit, Karanfili e ka fjalën.

**Karanfil Haxhillari:** I lexova të gjitha nenet e sidomos e pashë prej nenit 20 në fakt prej nenit të ujësjellësit 11 e deri në nenin 30 poshtë që ka të bëjë vetëm me ujësjellësin. Si kyqet një konsumator, çfarë duhet të bëjë një konsumator. Kjo është direkt përzierje në ndërmarrjen publike të Hidroregjioni Jugor, një. E dyta, në qoftë se kjo rregullore kalon në këtë rast, këtë rregullore duhet me e zbatuar komuna e Prizrenit. Të cilën këto nene, të gjitha këto nene, humbim kohë me i përmend me i lexuar një nga një, janë kompetenca të ndërmarrjes publike Hidroregjioni! Dhe pse me u ngarkuar kjo rregullorja dhe komuna në këtë rast, por punët të cilat i kryen ndërmarrja publike Hidroregjioni. Ëh, një, e dyta, qe neni 17 më interesant është, ndalohej lidhja pa leje në rrjetin publik të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Kush i shqipton gjoba? Kush e dënon konsumatorin në qoftë se kyqet pa leje?

**Rrahim Destani:** Inspektorati komunal.

**Karanfil Haxhillari:** Jo bre, hidroregjioni na bjen faturën.

**Rrahim Destani:** Jo jo, më fal, këto janë shërbime komunale. Të gjitha rrjetet e ujësjellësve dhe kanalizimet janë objekte komunale, të cilat po i ndërton komuna dhe ne duhet me i trajtuar dhe me i mbikëqyr. Nuk guxon asnjë qytetar se ne kemi të bëjmë edhe me shëndetin e popullatës, se nuk guxon aty dikush me prek rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, po flasim në kushte normale me e dëmtuar edhe ne çfarë besimi kemi nëse nuk mbikëqyret edhe nuk trajtohet ajo me ekspertë të lamive të caktuara. Për atë arsye, drejtoria e inspektorateve i kontrollon edhe i mbikëqyr dhe kyqjet ilegale, edhe dëmtime të tjera të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Nuk do të thotë vetëm kyqja, mundet me u dëmtuar bazeni, mundet me u dëmtuar rrjeti në tërësi, shumë sende të tjera, shumë gjëra mundet me u dëmtuar. Mirëpo këtë inspektim edhe kompetenca ka qenë edhe është e inspektoratit komunal, se vendimi komunal me cilëm ne jemi duke punuar i ka të njëjtat, vetëm se ne e kemi, e kemi përpunuar këtë për shkak të bazës ligjore, që është baza ligjore më e vjetër, e ne po duam me pasur me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale edhe disa nene mos me na ardhur në kundërshtim me ligjet tjera.

**Karanfil Haxhillari:** Ju po thoni që Drejtoria e Inspektoriateve ka inspektorë që kontrollon kyqjet ilegale të ujit.

**Rrahim Destani:** Unë I kontrolloj.

**Karanfil Haxhillari:** Se paska ditë! Por unë e di që Hidroregjioni ka kontrollera edhe goxha me numër të cilët bëjnë kontrollat nëpër shtëpi për kyqje ilegale.

**Rrahim Destani:** Ne i kontrollojmë edhe kontrollert e Hidroregionit edhe qytetarët që kyqen ilegalisht. Inspektorati komunal i kontrollon edhe ata kontrollert e ujit që munden me keqpërdor punën edhe me i lidhur dikë ilegalisht edhe qytetarët.

**Kujtim Gashi:** Veç mos të mendojmë këtë tash kur po thotë ne e mbikëqyrim dhe i kontrollojmë që përjashtohet Hidroregjioni. Se kjo është një farë koordinimi që bëhet mes institucioneve dhe në rastin.

**Karanfil Haxhillari:** Veç pak, a do të bëhet apo është? veç edhe qeta ta sqarojmë. A do të bëhet kjo apo, po e lëmë rregulloren. Qkjo punë domethënë e kontrollit të kyqjeve ilegale prej inspektorëve komunal.

**Rrahim Destani:** Nëse je kuruar mundesh me ardhur.

**Karanfil Haxhillari:** Ama a ka qenë edhe më herët?

**Rrahim Destani:** Qe vendimi komunal, prit vetëm ta spjegoj.

**Karanfil Haxhillari:** O thjesht bre e kam, a ka qenë edhe më herët?

**Rrahim Destani:** Po.

**Karanfil Haxhillari:** Në rregull je. Shtatë vjet jam kanë.

**Rrahim Destani:** Je kanë por s'ke pasur rast. Nëse do mundesh me këqyr, a mundesh? Qe këtu neni 53 i Vendimit komunal që është në fuqi. Dëgjo, tash, më fal kryesuese meqenëse tash po duhet me ju spjegju pak më shumë.

**Antigona Bytyqi:** Jo këtu jemi për me u shpjeguar pak më shumë.

**Rrahim Destani:** Tash kyqjet ilegale në rrjetin publik të ujësjellësit dhe të kanalizimit kanë rënë për shkak se njerëzit, qytetarët me ndërtimin e rrjeteve të reja të kanalizimit të ujësjellësit janë kyç shumica. Edhe rrugët e reja kur bëhen, ndërmarrja me tenderin i obligon me u kyç në rrjetin publik të sjellësit dhe kanalizimit. Nuk lejohet me u prej asfalti menjëherë përpos rasteve urgjente që kanë kompanitë publike. Do të thotë ka KEKU, ka Hidroregjioni, ka mundet dëme të tjera me pas në rrugë, domethënë në hapësira publike. Ne jemi të folur këtu për hapësira publike, objekte komunale. Ky vendim është prej 2004-tës Karanfil, ne kemi punuar me qeta prej 2004-tës. Krejt 90% e kësaj rregullore është pjesë e këtij vendimi. Vetëm se baza ligjore këqyre në fillim është e moçme shumë e vjetër edhe neve nuk po na, dhe nuk është e arsyeshme me qenë. Edhe ka filluar me me u bë me u kundërshtu me ligjet e reja, për këtë arsye duhet me e rregullu këtë. Domethënë nuk ka kurgjo jashtë, 90% është qaj vendim.

**Karanfil Haxhillari:** Kërkush s'po thotë që ka jashtë, thjesht po du me u interesuar që kjo rregullore me 30 ka me u votuar, epse neve po na doken.

**Rrahim Destani:** çdo gjë që ka rreth rregullores, ne prej 2003-ës punoj me këtë vendim. Në 2004 ky është aprovu, prej 2003-ës punojmë me këtë vendim. Çka ka për këtë rregullore krejt pyetjet e mundshme, ju lutem parashtroni, nuk ka asnjë problem. Për të gjitha kemi mundësi me u përgjegjë se jemi në zbatim të këtij vendimi edhe e kemi praktikuar për 20 vjet, më shumë se 20 vjet jam udhëheqës i sektorit për shërbime komunale.

**Antigona Bytyqi:** Ju faleminderit. Dikush tjetër në qoftëse don me marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë po e hedhi pikën e tretë në votim.

**Dafina Alishani:** A bën veç edhe nenin 73 faktikisht. Vendosija e streheve për pritje të autobuzeve brenda dhe jashtë qytetit. Këtë e bën komuna.

**Rrahim Destani:** Komuna i vendos por edhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike duhet me u pajis me leje për objektet që i ndërtojnë ose këto strehat që i vendosin. Do të thotë duhet me leje të Drejtorisë për Urbanizëm në zonën jashtë zonës historike të qytetit. Brenda zonës historike të qytetit duhet me i përshtatur ligjit për qendrën historike të Prizrenit, sipas ligjit për qendrën historike të Prizrenit.

**Dafina Alishani:** Inspektor, ju po folni për çështjet ideale, qysh duhet me qenë. Ne kemi objekte komunale që janë nisë pa leje ndërtimore. Për rregullore pra disa herë e kam thënë edhe tash ju them ju zgjas dorën, më të mirë s'ka se komuna e Prizrenit, por me i respektuar nuk po i respektojmë. Veç çka po na lodhni këtu me rregullore, me analizimin e rregulloreve, na kemi objekte komunale që fillojnë pa leje! Streha për autobus është është obligimi i DSHP-së. Këtu po thotë që njeri, personi duhet me pru çertifikatën e biznesit, duhet me pru letërnjoftimin. A i bie kjo që unë sot me dashur me bërë një streh të autobusit, po mundsha me bërë?



**Rrahim Destani:** Po nuk mundet me bërë se ajo llogaritet si një kompani që mundet me marrë një punë me e kryer. Në këtë rast Drejtorja e Shërbimeve Publike po i bën vetë këto, për atë arsye Drejtorja e Shërbimeve Publike në bazë të projektit merr leje në Drejtorinë të Urbanizimit. Për krejt këto problematika sikur për ujësjellës, si për kanalizim sikur për këto problematika të tjera që janë. Në momentin që inspektorët hasin, unë po flas për vehte edhe për të tjerat, ato që po thua ideale na mirë kish me qenë, po sa mundet me qenë. Në momentin që ne i hasim, ne i shënojmë, i shkruajmë edhe kur s'ka leje edhe kur ka leje.

**Dafina Alishani:** Ani duhet me marrë veprime konkrete.

**Rrahim Destani:** Kemi marrë patjetër.

**Dafina Alishani:** Ju s'jeni tu marrë.

**Rrahim Destani:** Nejse tash unë s'po du me.

**Dafina alishani:** Po mirë. Sa objekte keni, sa investime kapitale i keni pa leje dhe ju nuk keni guxim me inspektuar vetë komunën. Që do po ta jap listën, nëse keni guxim, shkoni këqyrni a kanë leje apo jo?

**Rrahim Destani:** Secili i ka kompetencat e veta.

**Dafina Alishani:** E thash po e arsyetove.

**Rrahim Destani:** Në kuadër të kompetencave për inspektoratin komunal, inspektoratet e tjera janë kompetenca të tjera.

**Dafina Alishani:** Po dhe unë po flas për inspektoratin komunal.

**Rrahim Destani:** Po po, por inspektorati komunal ndahet për çështje komunale. Në kuadër të inspektorat komunal janë disa. Kemi inspektoratin e ndërtimit që merret me ndërtimin, kemi inspektoratin e komunikacionit, për mjedis edhe inspektorat komunal, domethënë i kemi edhe të tregut. Domethënë i kemi pesë sektor që operojnë në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit.

**Antigona Bytyqi:** Nëse s'keni edhe dikush tjetër, atëherë po e hedhim në votim pika e tretë që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Kush është për? Jemi dy, tre kundër. Atëherë pika e tretë nuk i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Ju faleminderit. Kalojmë te pika e katërt.

#### **Pika e katërt:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së kryetarit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 31 mars 2022.**

**Antigona Bytyqi:** Besoj që e keni parë edhe kërkesën e kryetarit që më është drejtuar, po ashtu edhe vendimin që e kemi marrë. Pra, nga kjo kërkesa e kryetarit është kërkuar që anëtari i komisionit Besnik Krasniqi të zëvendësohet me një anëtar tjetër. Pra, që ka të bëjë me komisionin komunal të aksioneve të ndërmarrjes publike Eko-regjioni. Në qoftë se dikush dëshiron me marrë fjalën?

**Karanfil Haxhillari:** Deshta, meqënëse Kujtimi këtu vjen në zëvendësu kryetarin apo? edhe. Kjo pikë. Edhe kjo pike, po jo, unë e di që KPF-ja përbëhet prej anëtarëve përfaqësuesve politikë të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend. Po ish kanë mirë me na zbërthy në këtë rast Kujtimi si pikë e kryetarit e propozuar.

**Kujtim Gashi:** Po lyp sqarim apo?

**Karanfil Haxhillari:** Veç për qeta po besoj që je këtu, se ndoshta për tjetër send s'je apo?

**Kujtim Gashi:** Patjetër. Në fakt ju e dini që aty në këtë vendim janë të përfshirë tre anëtarë, dy i propozon kuvendi edhe një anëtar e propozon Kryetari i Komunës. Sa i përket pjesës ku dy i ka përcaktuar kuvendi, ajo mbetet e pandryshueshme, ndërkohë te pjesa ku kryetari e ka të drejtën ligjore me propozuar njërin prej kandidatëve, e ka analizuar dhe ka menduar që duhet me pas një ndryshim edhe e ka propozuar këtu meqë është kategori ligjore e cila i takon Kryetarit të Komunës për me propozuar. Domethënë nuk ka shumë shtjellime pse, po e ka pa të arsyeshme me pas një anëtar tjetër në këtë në këtë komision. Sigurisht që në kuvend propozohet edhe emri edhe besoj që do të jetë një prej drejtorëve komunal që e ndërlihdh me punën e Eko-regjionit. Natyrisht kjo bëhet për me rritur pak më shumë performancën e komunës në raport me Eko-regjionin edhe me aktivitetin që e zhvillon Eko-regjioni në qytetin e Prizrenit.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit, dikush tjetër?

**Karanfil Haxhillari:** Meqënëse është propozimi i kryetarit, as s'kishte mundur ky komision, ky anëtar i komisionit duhet të votohet patjetër në asamble apo?

**Kujtim Gashi:** Ky nuk është patjetër, por vendimi duhet me u ndryshuar patjetër, sepse kryetari mundet në çdo kohë me i ndërruar anëtarët e vet të cilët i propozon nëpër këto komisione dhe borde.

**Antigona Bytyqi:** Kemi me bërë plotësim-ndryshim të vendimit?

**Kujtim Gashi:** Po meqë tash figuroj emri i këtij.

**Adem Shabanaj:** Është filluar me vendim të kuvendit.

**Kujtim Gashi:** Domethënë ne e kemi respektuar një vendim që e ka marrë kuvendi edhe e kemi prurë për.

**Dafina Alishani:** Pastaj a vjen emri atë ditë?

**Antigona Bytyqi:** Po po, si zakonisht qysh e kemi parë.

**Kujtim Gashi:** Po vjen emri.

**Adem Shabanaj:** Propozohet prej kryetarit dhe votohet.

**Antigona Bytyqi:** Po. Nëse nuk kemi dikush tjetër, po i hedhim në votim edhe pikën e katërt. Prezent jemi pesë anëtarë.

**Kujtim Gashi:** Tash s'po du me hy me këtë temë se ne për një korreksi këtë farë punën se edhe me opozitën i kemi ndarë. Kjo është është pozitë që e propozon kryetari i komunës dhe se kuptoj pse duhet me pas dilema.

**Dafina Alishani:** A bënë nja pesë minuta kohë se s'un po mirremi më vesh?

**Antigona Bytyqi:** Prezent jeni pesë anëtarë, kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes së Kuvendit? Katër për, zero kundër, një abstenim. Atëherë edhe kjo pikë i rekomandohet mbledhjes së Kuvendit, ju faleminderit.

**Karanfil Haxhillari:** Shihe, kuvendarët po dalin në lajthitje në këtë rast, a po kupton?

**Kujtim Gashi:** E për mos me dalë unë e kam një propozim që në propozimet e kryetarit nuk duhet emrat me i shkruajt në vendim. Se janë janë e drejta e kryetarit, e ndërron kur të don, e bjen kur të don. A ka të drejtë tani me ndërru pa vendim, ju po thoni pa vendim.

**Kujtim Gashi:** Jo, unë e kam qyrë shumëmicën e komunave, te rasti i kryetarit nuk ka emër. Ka vetëm te asamblistat që i propozon me vendim të kuvendit. Është mirë me u krijuar një praktikë që te propozimet e kryetarit mos me pas emra.

**Florent Ukaj:** Ajo ka qenë një marrëveshje, nëse i përmbahemi marrëveshje, edhe ne s'mundemi me ja përcaktu kryetari, s'kemi variant tjetër te kryetari, as s'un ja propozojmë kryetarit.

**Karanfil Haxhillari:** Po ama edhe ministrinë e lindjes e kërkojnë që kur t'i shkon për ligjshmëri kur t'i shkon komisioni me i shkuar me emra.

**Kujtim Gashi:** Për dy po, për një jo.

**Karanfil Haxhillari:** Na po më duket nuk kemi kërkuar paqare emrin.

**Florent Ukaj:** Jo e ka kërkuar një përfaqësues i komunës që me pas emrin patjetër, Gruseli ka dhënë me pas emrin patjetër.

**Antigona Bytyqi:** Për OJQ-të ajo ka qenë, ndosha vlen edhe këtu. Ju faleminderit. Kalojmë te pika e pestë.

### **Pika e pestë:**

#### **Raporti financiar janar- mars 2024. Gjafer, fjala për juve.**

**Gjafer Ponik:** Përshëndetje për të gjithë. Këtë seancë ka mu prezantu edhe raporti janar-mars 2024. Zakonisht ky raport bëhet prej të hyrave edhe prej shpenzimeve komunale. Nëse ka nevojë për sqarim diçka unë jam këtu. Nëse ka nevojë mund me hy ngapak në pika ç'donjërin me sqaruar, me tabela, me sene.

**Karanfil Haxhillari:** A mundesh veç me na kallëzu shpenzimet e drejtorive në përqindje për tremujorshin e pare në këtë rast?

**Kujtim Gashi:** Kapitalet 21 më duket.

**Karanfil Haxhillari:** Që s'un e gjen, në rregull.

**Gjafer Ponik:** Jo jo, por me sa po e shoh këtu nuk i kanë cekur përqindjet, veç i kanë si shuma se sa është planifikimi, sa është shpenzimi. Për asamble ju kam thënë që duhet me prezantuar me përqindje, mirëpo prap po e shoh që ka shkuar domethënë raporti sikur i mëhershëm domethënë, veç është diferenca këtu, me përqindje nuk e kanë qit përqindjet.

**Kujtim Gashi:** Prej janarit deri në 31 mars, apo 28 mars sa është ajo.

**Gjafer Ponik:** Po, totali i përqindjeve është 20.89%

**Kujtim Gashi:** 21 pikë diçka është, unë që kam nxjerrë kështu pa juve.

**Gjafer Ponik:** Te investimet kapitale janë me përqindje, nëse e ke faqen 14.

**Kujtim Gashi:** Që është lajm I mire në krahasim me vitin e kaluar është më i mirë.

**Antigona Bytyqi:** A ka ndonjë pyetje tjetër? Urdhëro Dafina.

**Dafina Alishani:** Puna e pagesave të nënave lehona pasi je veç i qasaj drejtorie. Unë nuk e di çka jena duke pritur më shumë! Përzgjedhja është bërë, ankesat janë marrë parasysh, po unë po dëgjoj që ankesat.

**Gjafer Ponik:** Unë kam qenë edhe kryetar e komisionit, ne si komision e kemi përfunduar punën tonë, mirëpo problemi ka qenë me sigurimin e mjeteve prej kategorisë subvencioneve. Po besoj që këtë muaj ka mundësi, ka të hyra më shumë edhe kanë me u bartë një pjesë e atyre të hyrave në kategorinë e subvencioneve.

**Dafina Alishani:** Domethënë hala kanë me i pritur qytetarët.

**Gjafer Ponik:** Deri tash në fund të muajit jo, nuk ka asnjë pagesë, domethënë në maj, në fillim të majit besoj do të fillojnë.

**Kujtim Gashi:** Në maj do të fillojnë se tash për me sqaruar, subvencionet zakonisht para prillit s'ka, se ato vijnë prej të hyrave edhe diku nga fundi i marsit fillojnë me ardhur subvencionet. Fatkeqësisht deri tash kanë qenë nja 200-300 mijë euro subvencione që janë paguar obligimet e vitit të kaluar. Tash në maj pritet me ardhur një shumë më e madhe, ndoshta diku rreth 1 milion.

**Dafina Alishani:** Qysh, subvencionet e vitit të kaluar si vjet i keni paguar a?

**Kujtim Gashi:** Obligimet, se janë këto obligime për shembull nëse një vendim është marrë në dhjetor, ai është obligim, se s'un e kryejmë në dhjetor, s'un e paguam. Domethënë mbarten si obligime për vitin e ardhshëm edhe zakonisht ky marsi prilli i kryen obligimet. Tash nëse të tyrat kanë qenë të mira që sipas raportit janë janë të mira, mund me pas një shumë më të madhe komuna në dispozicion të subvencioneve edhe me fillu pagesat e nënave lehona e që besoj për maj edhe

qershor mund me u ekzekutuar shuma në total. Përndryshe deri tash kanë qenë procedurat, kanë pasur edhe ankesa.

**Dafina Alishani:** Mos bre Nënkyetar të lutna, procedurat janë krye një muaj e gjysmë.

**Kujtim Gashi:** Ndoshta pak më vonë.

**Dafina Alishani:** Jo, një muaj e gjysmë, tash ta gjej edhe afatin para dy seanceve ne e patëm si shqetësim.

**Kujtim Gashi:** Kur është krye afati i ankesave?

**Gjafër Ponik:** Afati i ankesave me 30 mars ka pasur me përfund.

**Kujtim Gashi:** 30 mars, tash jemi në prill, domethënë as një muaj. Po s'është kjo relevante.

**Gjafër Ponik:** Saktësisht nuk po e di po, sepse unë kam qenë veç kryetar domethënë i këtij komisionit, por anëtarët e komisionit janë tjetër të ankesave. Me sa e di është 30 ditë ka qenë afati i ankesave pas datës së publikimit. Nëse s'gaboj 15 mars atëherë duhet me qenë.

**Kujtim Gashi:** 1 muaj e 10 ditë.

**Gjafër Ponik:** Është edhe shuma, e kalon 540 mijë euro për të gjithë, është shumë e madhe dhe një pjesë e të hyrave domethënë kanë qenë të hyrat pak më pak, por këtë muaj ka të hyra për shkak edhe është kësti i parë i tatimit të pronë që duhet me u paguar edhe ka më shumë të hyra për muajin prill.

**Antigona Bytyqi:** Po e hedhi në votim edhe këtë pikën e pestë që ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika e gjashtë.

### **Pika e gjashtë:**

**Informatë rreth raportit të punës së zyrës së njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore për vitin 2023.**

**Antigona Bytyqi:** Fjala për juve zonja Mybexhele.

**Mubexhele Zhuri:** Unë edhe këtë here kam u ankuar se jam vetëm në atë njësi, s'kam çfarë bëj, duroj nëse do të jeni në asamble. Po i përgjigjem sëpari drejtorit, kryetarit, pastaj Ministrisë së Pushtetit Lokal, Agjencionit për Barazime Gjinore, Komisionerit për Përdorim të gjuhëve. Kam edhe një është zyra e për qeverisje të mirë. Dhe kam shumë raporte, shumë matrica, non stop jam duke plotësuar, besoni prej janarit deri tash dhe veç kam plotësuar raporte e matrica!. Ndërkohë është punuar në planet e punës, e kemi konstituar ekipin për të drejtat e fëmijëve, e kemi filluar edhe e kemi mbaruar diku në janar apo shkurt planin e punës për ekipin e fëmijëve. Kemi filluar me analizën gjinore në dy drejtori, Drejtoria e Kulturës, ajo është kryer dhe janë dhënë rekomandime, kanë hyrë nëse keni vërejtje dy objektiva në KAB dhe gjithashtu kemi bërë analizë gjinore dhe në Drejtorinë e Bujqësisë, kjo vazhdon. Pra sot më thirrë që do të ndërmerren veprimet rreth trajnimit të zyrtarëve për ta bërë analizën gjinore. Se në çdo drejtori duhet të instalohet ë

analizat gjinore, duhet të trajnohen njerëzit për me ditë se si ta bëjnë analizën gjinore, në bazë të cilave dokumenteve të nxjerrin gjetura edhe rekomandime pastaj të cilat duhet të realizohen. Gjithashtu kemi filluar me planin komunal për barazi gjinore, që do të jetë plan i komunës, jo i zyrës time, se unë kam një plan pune, i cili bazohet në programin e Kosovës, po edhe plani komunal normalisht do të bazohet në këtë program, kemi arritur deri te drafti tash, kjo tash kalohet në këtë vit, mirëpo puna është kryesisht në vitin paraprak. Ka shumë takime, shumë trajnime që janë realizuar, shumë sfera janë përfshirë, por normalisht që asnjë sferë s'mundet shumë mu përfshi për shkak se një njeriu s'mundet në të njëjtën kohë edhe me raportuar dhe me bërë aktivitetet dhe pse sinqerisht me thënë jashtë mundësive nga njerëzit realizohen, ndaj nëse ka nevojë edhe ligjëratave edhe para grave dhe para fëmijëve për shkak se dua që ta përshpejtoj ose të kem rezultate apo të kem aktivitete në një sferë. Kështu që mundeni me pyetë. Fati është që na mbështesin nga një organizatë jo qeveritare, si DEMOS edhe në performancë gjithashtu kam qenë pjesë e punës janë në çdo gati komision, KKSB, për riintegrim, të gjitha këto marrin kohë. Ëh, por na ndihmojnë shumë komunën, edhe rreth analizës gjinore, edhe rreth planit të punës të komunës që ta realizojmë. Pra, kështu në përgjithësi.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit, Dafina fjalën.

**Dafina Alishani:** Zonja Mybexhele, ka vite që ankoheni që jeni vetë edhe ka vite që ne kemi raportime, domethënë të ankesave, nuk kemi rezultate se si është gjendja e respektimit të barazisë gjinore nëpër komunë. Unë sinqerisht po më vjen keq që të kanë lënë vetë, po më vjen edhe keq që s'kemi raportim të duhur për këto raste. Domethënë ju e keni paraqitur këtu monitorimin e zbatimit të udhëzimit administrativ mbi masën e veçantë për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve edhe rezultatin e keni bërë kërkesë për regjistrim të pronës së përbashkët. Ishte dashtë me ditë ne në vitin paraprak sa veta e kanë bërë regjistrimin në pronë në emër të përbashkët. Domethënë kjo nuk është raport, kjo është raport, kjo është veç hapat që ju i keni bërë për me shkuar në një cak, në një objektiv, por objektivin a e kemi realizuar nuk po dimë. Takime ju mundeni me pas gjatë ditës shumë takime, rezultati neve na duhet. Pastaj çka po bëni për shembull se në mandateve të kaluara keni qenë goxha të zëshëm. Tash e kemi një ekzekutiv që nuk e respekton 50-50-ën edhe pse ka pasur premtime, kemi pak drejtoresha! Zyra për Barazi Gjinore a ka pasur ndonjë takim me kryetarin, a i ka kërkuar me respektuar premtimin? Te pjesa e subvencioneve, a po monitorohen sa gra po marrin subvencione, sa jo? Unë atë raport e kisha pritur se sa jeni takuar, me kanë jeni takuar, pak ka rëndësi kur unë nuk kam në final, nuk kam një rezultat. Unë sinqerisht po dua me ditë sa prej pronave janë regjistruar në të dy emra bashkëshortëve, jo një. Ju veç e keni shkruajtur si rezultat që keni bërë kërkesë. Kërkesën e bëjmë secila grua.

**Mybexhele Zhuri:** Kompetencat e mia shkojnë deri atje që unë t'i kërkoj rezultatet prej drejtorisë e cila e zbaton këtë masë alternative, Drejtoria e Kadastrës. Dhe ata kur ju dërgojnë, sinqerisht me tha, kur ju dërgoj kërkesë për të dhëna e kërkoj edhe numrin e pronave të që janë emër të dy bashkëshortëve. Për vitin e kaluar nuk kam pranuar asnjë shkresë dhe nuk kam pasur unë në bazë të shkafit të raportoju. Edhe ky raport është formal faktikisht, sepse raportin e detajuar unë ja dërgoj Agjencionit për Barazi Gjinore.

**Dafina Alishani:** Jo, ju duhet të ja dërgoni edhe kuvendit. Zyra juaj e ka obligim me prezantuar raportin edhe në kuvend, se ju jeni në zyre.

**Mybexhele Zhuri:** Jo obligim nuk kam. Ky obligim nuk e kam pasur asnjëherë edhe kërkah nuk më shkruan në detyrat...

**Dafina Alishani:** Po ju tregoj ku ju shkruan organi më i lartë Kuvendi Komunal nëse e ka futur në rend ditës, nëse e ka futur në plan të punës, ju e keni obligim a është qashtu Kryesuese?

**Antigona Bytyqi:** Po e kemi.

**Mybexhele Zhuri:** Për informatë shkruan, jo raportim.

**Dafina Alishani:** Okej, po më vijnë informata sa persona e kanë regjistruar pronën në të dy. A keni informatë?

**Mybexhele Zhuri:** Për momentin këtu është një numër i cili ma ka dhënë drejtorja. Po jo me sqarim. Po mundohemi me gjetë këto të dhëna në bazë të ç'kafit mundemi me i plasu. Që prej fillimit kur ka filluar zbatimi i masës. Mirëpo secila drejtori duhet të merret me këtë çështjen e barazisë, nuk mundem unë në 13 drejtori me shkuar vazhdimisht edhe me mbledhë të dhëna. Aq sa kur ju kërkoj me shkresë, aq sa më japin informata, ato i përfshijnë në raport.

**Dafina Alishani:** Po s'kemi informata, këtu është problemi. Edhe ju jeni për me monitoruar punën e secilës drejtori në aspekt gjinor, me parë çfarë po bëjnë. Ju jeni direkt në kontakt me Kryetarin e Komunës. Ju jeni pjesë e secilit takim këtu që bëhet me drejtorët.

**Mybexhele Zhuri:** Jo nuk jam.

**Dafina Alishani:** Epo problem qenka atëherë. Problem qenka që s'po ju japin hapësirë, këtë duhet me e thënë, se në mandatin e kaluar e keni parë secilin takim.

**Mybexhele Zhuri:** Nuk mundet një njeri me i kryer krejt obligimet të një njësie.

**Dafina Alishani:** Ju lutem bëjeni kërkesën, qe sa vjet të kemi në raportim, çdo vit marrim premtim që kanë me ta pru një asistent edhe nuk ta kanë pru. S'është normale kjo, çdo vit me pas ankesën e njëjtë, asnjë progres mos me pas edhe mos me ditë çfarë po ndodhë në këtë zyrë, raportimet na vijnë vonë. Unë po them, mos e merr këtë personale, nuk është kjo e duhura çka çka ishte dashur. Edhe unë jam me mendimin që barazia gjinore bëhet prej secilës drejtorie jo prej një zyrtari. Po zyrtarja duhet pak me ngritë zërin, se për qato është aty, edhe duhet me na informuar së paku asamblestëve që nuk po përfilllet kjo. Nëse ne e dimë që, unë këto mund me ju siguru ndoshta jo Vetëvendosja, por një anëtare e PDK-së mundet me lobu te kryetari, ose te kryesuesja me thënë, a mundesh me ftuar zyrtaren për barazi gjynore kur keni takime me drejtoritë? Duhet, obligim është. Mybexhele Zhuri: Unë bashkëpunoj me Komitetin për Barazi Gjinore dhe brought e mia edhe aty i kam paraqitur.

**Dafina Alishani:** Po veç ne jemi përgjegjës për me siguruar një ambient të barabartë për secilin qytetar. Edhe ne të kuvendarët edhe me neve duhet me i treguar këto shqetësime që i kemi. Edhe me kryesuesen, me secilën, jo veç gratë, secili qytetar këtu që pak e ka një ndjeshmëri për barazi gjinore, është dashur me u shqetësuar për këtë gjendje të zyrës së juaj.

**Mybexhele Zhuri:** Po kjo kërkesë ka shkuar sa herë në asamblenë. Nuk është që s'ka shkuar edhe prej meje edhe prej Komitetit për Barazi Gjinore, por ka mbetë ashtu si kërkesë me vite të tëra.

**Dafina Alishani:** E flas unë në kuvend, e pyes kryetarin, se shumë ka pasur premtime për barazisë gjinore e tash nuk e respekton asnjë zyrtare e lëre më gratë tjera.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit, dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë po e hedhim në votim dhe pikën e gjashtë. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e fundit.

**Pika e shtatë:**

**Raporti i komisionit të Aksionarëve të stacionit të autobusëve.**

**Antigona Bytyqi:** Fjalën e ka Ademi.

**Adem Shabanaj:** Faleminderit, përshëndetje edhe njëherë për të gjithë. Materialin nuk kemi mundur me ja u sjellë fizikisht, mirëpo zyra e kryesueses ja u dërgon përmes e-mailëve. E kisha pa të arsyeshme me raportuar në kuvend më mirë edhe e kishim disku atje. Nëse veç keni diçka për të plotësisht. Një raport të shkurtër e kam, mirëpo veç vetëm raportin e kam. Nuk e kam planin e biznesit e të gjitha ato rregulloret, statutin e ndërmarrjes që kemi përgatitur, do t'i pranoni përmes emailit dhe më pastaj diskutojmë edhe në kuvend më gjërësisht.

**Antigona Bytyqi:** Edhe unë pajtohem plotësisht në qoftëse pajtohen edhe kolegët e tjerë A po pajtoheni? Po e lëmë vetëm për kuvend? Atëherë po e hedhim në votim edhe pikën e shtatë.

**Karanfil Haxhillari:** Sot na vjen si material apo?

**Antigona Bytyqi:** Po, Po ato që na i ka dërgu Ademi ja u përcjellim si material. Atëherë po e hedhim në votim që t'ju rekomandohet edhe kjo pike kuvendit. Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit shumë. Faleminderit që morët pjesë në këtë mbledhje dhe shihemi në mbledhje të kuvendit.

Përfundoi në ora 10:59 minuta.

**Kryesuesja e Kuvendit**  
**Antigona Bytyqi**

